

U R D H Ë R E S Ë
Nr.12, datë 15.12.1993

**PËR MOBILIZIMIN E SHTETASVE QË I NËNSHTROHEN SHËRBIMIT TË
DETYRUESHËM USHTARAK**

Për zbatimin e kërkesave të ligjit për shërbimin ushtarak të shtetasve, me gjithë punën e mirë dhe masat e marra në këtë drejtim, është vërejtur se nga shtetas të ndryshëm ka shmangie ndaj detyrimeve që kanë për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv e në rezervë, si dhe për detyrime të tjera ndaj mbrojtjes. Këto veprime janë favorizuar edhe nga puna e dobët, si dhe nga moszbatimi në kohë e si duhet i detyrimeve që kanë vetë organet shtetërore në këtë drejtim.

Me qëllim që të gjejnë zbatim në çdo kohë kërkesat e ligjit për shërbimin ushtarak të shtetasve dhe për realizimin me sukses të mobilizimit,

U R D H Ë R O J :

1. Problemet e mobilizimit e të evidencës ushtarake të shtetasve, të lajmërimit e të paraqitjes së tyre në rast thirrjeje për kryerjen e shërbimit ushtarak aktiv ose të rezervës, për prova gatishmërie për mobilizim të pjesshëm e të përgjithshëm të vlerësohen drejt dhe të trajtohen në mbledhje të veçanta të këshillit të rrethit (bashkisë).

2. Në çdo periudhë mobilizimi të rekruteve të rinj që bëhet për plotësimin e reparteve të ushtrisë, me kërkesën e kryetarit të degës ushtarake të rrethit, kryetari i këshillit të rrethit dhe kryetari i bashkisë të organizojnë takime me kryetarët e komunave, me drejtuesit e administratave në lagje, me komandantin e njësisë më të lartë në rreth, me kryetarin e degës së rendit dhe kryetarin e policisë ushtarake, me kryetarin e gjykatës e të prokurorisë dhe të përcaktojmë masat e duhura për realizimin 100 për qind të mobilizimit.

3. Degëve ushtarake, si organe mobilizimi në rreth, t'u jepet mbështetja e plotë ligjore, duke zbatuar secili detyrimet për mobilizimin, veçanërisht detyrimet që rrjedhin nga nenet 25 e 27 të ligjit, për lajmërimin dhe sigurimin e paraqitjes së shtetasve që thirren.

4. Për problemet që dalin dhe masat që do të merren për mobilizimin e ri të rekruteve, të informoni në Këshillin e Ministrave.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi